



**VENDIM**

*Nr. 52, Datë 29.04.2016*

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI ” SH.P.K., NË  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2 dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LIRIA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie;

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “LIRIA ENERGJI ” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4/10 gërmat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**